



Planor / Dokument Zemëre / Prilidje Korrespondencë / Organ / Institucione Org. / Unit.	Emri / Titulli / Prof. No.	Shtojca / Pilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKPM/SHK	256/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1016/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1016/2021 të datës 07.12.2021, të parashtruar nga ankuesit të cilin me autorizim e përfaqëson Avokati kundër Vendimit me Nr.1572 të datës 22.11.2021 të Udhëheqësit të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 19.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.1016/2021 të datës 07.12.2021, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi përmes përfaqësuesit të autorizuar, avokati me datë 03.12.2021 ka parashtruar ankesën me numër protokolli 5847 të regjistruar me numër A.nr.1016/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.1572 të datës 22.11.2021 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, përmes të cilit ankuesit i është refuzuar ankesa si e pa bazuar lidhur me aplikacionin e dorëzuar për pozitën e punës Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Kosovës për Administratë Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 20.12.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë te Departamenti për Menaxhimin e

Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Këshilli, me datë 28.12.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 5847 të regjistruar me numër A.nr.1016/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin e datës 25.07.2021 për pozitën Drejtor i Përgjithshëm në Institutin e Kosovës për Administratë Publike; Emailin e datës 12.07.2021 nga ankuesi për Emailin e datës 14.07.2021 nga ankuesi për Vendimin me Nr.23/2020 të datës 15.11.2021 të Udhëheqësit të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Konkursin e datës 16.10.2021 për pozitën Drejtor i Përgjithshëm në Institutin e Kosovës për Administratë Publike; Njoftimin e datës 15.11.2021; Emailin e datës 15.11.2021 nga për ankuesin; Ankesën e datës 18.11.2021 e parashtruar nga ankuesi në Divizionin për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit; Vendimin me Nr.1572 të datës 22.11.2021 të Udhëheqësit të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Vendimin me Nr.0361/2021 i datës 17.06.2021 për caktimin e zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të IKAP-it; Shkresën me titull Ministri përzgjedh kandidatin më të dobët për drejtor të IKAP; Autorizimin e datës 01.12.2021; Letërnjoftimin e ankuesit; Zarfin e datës 03.12.2021; Kërkesën për Përgjigje në ankesë e datës 20.12.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 28.12.2021; Dëshmi për aplikacionin e ankuesit datë 29.10.2021; Certifikatën e datës 02.08.2021 për përfundimin e studimeve Master në Programin Menaxhment i Përgjithshëm Ndërkombëtar; Certifikatën e datës 22.11.2000 të lëshuar nga Fakulteti Filozofik; Vërtetimin e datës 02.09.2002; Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë-Dega Istog e datës 03.08.2021; Formular për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike i datës 23.06.2021; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punës 2019 i datës 20.12.2019; Vendimin A.nr.400/2021 i datës 16.06.2021 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Certifikatë e datës 14.06.2001; Certifikatë nga IOM; Certifikatën e datës 20.12.2005; Certifikatën e datës 17.09.2005; Certifikatën e datës 13.06.2005; Certifikatën e datës 20.06.2008; Certifikatën maj 2010; Certifikatën 3-5.11.2010; Certifikatën 2013; Certifikatën për Auditor të Brendshëm i Cilësisë e datës 25.01.2013; Certifikatën shkurt 2014; Certifikatën 20-21.10.2014; Certifikatën 22.10.2014; Certifikatën e datës 30.04.2016; Certifikatën e datës 20.10.2021; Certifikatën e datës 17.09.2012; Akt Emërimit e datës 30.03.2012; Listën e aplikantëve (të aprovuar dhe të refuzuar) nga SIMBNJ; Emailin e datës 18.11.2021 nga ankuesi për Emailin e datës 15.11.2021 nga për ankuesin; dhe Vendimin Nr.02/2022 të datës 06.01.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për *përfundimin e procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.1016/2021 të datës 07.12.2021, sepse:*

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 16.09.2021 ka publikuar njoftimin lidhur me konkursin për pozitën e punës "Drejtor



i Përgjithshëm në Institutin e Kosovës për Administratë Publike” në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ku afati për aplikim ka qenë nga data 16.10.2021 deri më datë 30.10.2021.

Me datë 29.10.2021, ankuesi ka aplikuar në pozitën përkatëse të punës, ku si dëshmi është aplikacioni me numër RAN0001269. Udhëheqësi i Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, me datë 15.11.2021 ka nxjerr Vendimin me Nr.23/2021 përmes të cilit ka refuzuar aplikacionin me numër RAN0001269 të ankuesit, me arsyetimin se i njëjti nuk ka ofruar dëshmi lidhur me kualifikimin universitar në drejtimet që janë kërkuar me konkurs.

I pakënaqur me Vendimit Nr.23/2021 të datës 15.11.2021 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ankuesi me datë 18.11.2021 ka parashtruar ankesë të organi i njëjtë, gjegjësisht Divizion për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë. Ky i fundit me datë 22.11.2021 ka nxjerr Vendimin me Nr.1572/2021 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit dhe ka lenë në fuqi Vendimin Nr.23/2021 të datës 15.11.2021.

Kundër Vendimit Nr.1572/2021 të datës 22.11.2021 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale administrative; konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes materiale, dhe shkeljes së dispozitave materialo-ligjore, dhe rrjedhimisht ankuesi ka kërkuar të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet Vendimi Nr.1572/2021 i datës 22.11.2021 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë dhe lënda të kthehet në rishqyrtim, si dhe të pezullohet konkursi i datës 16.09.2021 deri në vendosjen meritore të kësaj çështje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë administrimit të provave ka gjetur se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datë 06.01.2022 ka nxjerr Vendimin Nr.02/2022 përmes të cilit ka anuluar Konkursin për pozitën e punës *Drejtor i Përgjithshëm në Institutin e Kosovës për Administratë Publike*, me Nr.RN00007618 të datës 16.09.2021.

Andaj, meqenëse se ankuesi ka parashtruar ankesë kundër Vendimit Nr.1572/2021 të datës 22.11.2021 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë përmes të cilit ankuesit i është refuzuar ankesa si e pa bazuar dhe ka mbetur në fuqi Vendimi Nr.23/2021 i datës 15.11.2021 për refuzimin e aplikacionit me numër RAN0001269 të ankuesit, si dhe duke marr parasysh se pretendimi i ankuesit ka qenë anulimi i Vendimit Nr.1572/2021 të datës 22.11.2021 dhe rrjedhimisht kthimi i lëndës në rishqyrtim, me qëllim të pranimit të aplikacionit për pjesëmarrje në procedurë të rekrutimit, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vlerëson se Vendimi Nr.02/2022 i datës 06.01.2022 për anulimin e konkursit për pozitën e punës *Drejtor i Përgjithshëm në Institutin e Kosovës për Administratë Publike*, ka bërë që objekti për të cilin ka filluar procedura, gjegjësisht pretendimi ankimor i ankuesit të bëhet i pamundur në kuptim të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.


Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1016/2021

Avdyll BEKTESHI


Procesmbajtës



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit, Avokatit
- Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

